



NJOFTIM

Në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, dhe nenin 91 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP nxjerr kete njoftim per te **RI-KUJTUAR** te gjitha **Autoritetet Kontraktuese** dhe **Operatoret Ekonomik**:

1. Zbatimin e VENDIMIT Nr: 48/2018 te dates 05/07/2018, ku eshte specifikuar:

*Te gjitha **aktivitetet e prokurimeve te centralizuar** te cilat do te zhvillohen nga Agjencia Qendrore nga data 05.07.2018 (Njoftimet për Kontrate te cilat publikohen ne ose pas kësaj date) do te jene krejtësisht elektronike duke përfshirë edhe dorëzimin e ofertave (nuk do te ketë dorëzimi te ofertave fizike).*

*Te gjitha **aktivitetet e prokurimeve me vler te madhe** te cilat do te zhvillohen nga Autoritetet kontraktuese nga data 01.09.2018 (Njoftimet për Kontrate te cilat publikohen ne ose pas kësaj date) do te jene krejtësisht elektronike duke përfshirë edhe dorëzimin e ofertave (nuk do te ketë dorëzimi te ofertave fizike).*

*Me këtë vendim i lejohet AQP-se përkatësisht te gjitha Autoriteteve Kontraktuese qe ne te gjitha aktivitetet e Prokurimit te specifikuar me lart dhe te iniciuara ne ose nga datat e cekura me lart te vendosin kushtet dhe te pranojnë nga operatoret ekonomik **vetëm ofertat e dorëzuar ne forme elektronike.** “*

Pra, **Operatoret Ekonomik** jane te obliguar qe per te gjitha procedurat e prokurimit me **“Vlerë te madhe”** te publikuara nga data **01.09.2018**, te dorezojne ofertat **vetem ne forme elektronike.**

2. Zbatimin e **“Ndryshim/Plotësimet e A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik”** te dates **03.09.2018**, sidomos përdorimin e formularit **B58-NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**.

Ne rastin e përdorimit të formularit **B58-NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, të gjitha **AUTORITETET KONTRAKTUSE** duhet që t'a publikojnë verzionin e fundit të këtij dokumenti që ka hyr në fuqi që nga data **03.09.2018** të cilin mund ta shkarkojn nga <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, tek: **Legjislacioni – Legjislacioni Sekondar**.

1. Zbatimin e **INTERPRETIMIT Nr: 149/2017** te dates **05/04/2017**.

Sipas këtij interpretimi me rastin e përgaditjes dhe dorëzimit të ofertës elektronike, **Operatoret Ekonomik** nuk duhet të ngarkojnë në sistem të prokurimit elektronik **Dosjen e tenderit dhe kopjet e kontratave** (ngarkohet vetëm lista e kontratave me nr përkatës të referencës).

Gjithashtu nëpërmjet këtij njoftimi i keshillojme të gjithë **Operatoret Ekonomik** që:

- përgaditjen dhe dorëzimin e ofertave elektronike të **mos e lënë për momentin e fundit**, por përgaditjet (p.sh. ngarkimi i dokumenteve dhe puna në hapa të tjera) të fillojnë shumë më herët, t'a leni të gatshme ose t'a dorëzoni duke patur parasysh që ofertën mund ta tërheqni, ndryshoni dhe ri-dorëzoni deri në momentin/afatin e fundit për dorëzim të ofertave;
- Gjate përgaditjes dhe dorëzimit të ofertave elektronike të ndjekin udhëzimet nga **“Manuali për OE- Përgaditja dhe dorëzimi i Ofertes”**, dhe të kontaktojnë shërbimin e HelpDeskut të KRPP-se për çfarëdo sqarimi apo ndihme teknike.